

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN**

**“PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE MËNYRËS SË SHPËRBLIMIT TË
DREJTË PËR HUADHËNIEN PUBLIKE”**

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, është përafruar me direktivën 2006/115/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12.12.2006 “Mbi të drejtën e qirasë dhe huadhënies publike”, e cila garanton mbrojtjen e të drejtës së huadhënies publike për autorët dhe mbajtësit e të drejtave.

Skemat e të drejtës së huadhënies publike janë krijuar sepse mbajtësit e të drejtave nuk kanë mundësi të kompensohen për huadhënien falas të veprave të tyre nga bibliotekat publike. E drejta e huadhënies publike është e drejta ligjore që kanë autorët për të marrë pagesë nga qeveritë, si kompensim për huazimin e lirë të veprave të tyre nga bibliotekat publike dhe të tjera.¹ Huadhënia publike përkufizohet si vënia në dispozicion për përdorim e një vepre për një periudhë të kufizuar kohe dhe jo për përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta pasurore apo tregtare, përmes institucioneve që lejojnë aksesin e publikut dhe që, për këtë qëllim, e kryejnë këtë aktivitet si shërbim publik. Autorët kanë të drejtën ekskluzive të autorizimit apo ndalimit të huadhënies publike të veprave, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga ligji nr. 35/2016, në të cilat autorët gëzojnë vetëm të drejtën për marrjen e shpërblimit të drejtë për përdorimin publik të veprës së tyre.²

Në pikën 8, neni 32, ligji parashikon se procedura dhe mënyra e shpërblimit të drejtë për huadhënien publike, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTVENDIMIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.

Miratimi i këtij projektvendimi është në përputhje me vendimin nr. 818, datë 26.12.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2025”, në të cilin për Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, miratimi i këtij projektvendimi është planifikuar në katër mujorin e tretë të vitit 2025. Referuar nenit 187, pika 5, të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, parashikohet se “pika 8, e nenit 32, pika 7 e nenit 16/1, të këtij ligji, zbatohet në datën e hyrjes së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”. Bazuar në

¹ PLR an introductory guide, International Authors Forum 2017.

² Neni 32, i ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.

këtë parashikim, pavarësisht datës së miratimit të projektvendimit, zbatimi i tij do të nisë në datën e parashikuar në nenin 187.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Vendosja e një sistemi funksional të së drejtës së huadhënies publike në Republikën e Shqipërisë përbën një instrument të rëndësishëm për garantimin e shpërblimit të drejtë dhe proporcional për autorët, si dhe për nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të krijimtarisë letrare, artistike dhe kulturore. Ky mekanizëm, i zbatuar në shumicën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe në vende të tjera me traditë të konsoliduar kulturore, ka dëshmuar efikasitet në sigurimin e të ardhurave të qëndrueshme për krijuesit, duke kontribuar në ruajtjen e diversitetit gjuhësor e kulturor dhe në mbështetjen e kategorive të autorëve që kanë më pak akses në burime financiare, si përkthyesit dhe autorët e letërsisë për fëmijë. Projektvendimi përcakton qartë kategoritë e veprave dhe subjekteve përfituese, metodologjinë e shpërndarjes së fondeve dhe burimin e financimit, duke garantuar transparencë, barazi trajtimi dhe efikasitet administrativ. Vendimi pritet gjithashtu të nxisë botimin e veprave me rëndësi të veçantë kulturore e shoqërore, të cilat shpesh nuk mbështeten nga tregu për shkak të interesit më të kufizuar tregtar, si dhe të forcojë rolin e bibliotekave publike si qendra kryesore të qasjes së lirë në dije dhe art, duke pritur njëkohësisht shtimin e interesit të publikut për marrjen hua të librave, si rezultat i motivimit të autorëve për të pasuruar më tej repertorët e bibliotekave kombëtare.

Zbatimi praktik i sistemit të huadhënies publike paraqet një sërë sfidash institucionale dhe organizative. Aktualisht, mungon një agjenci funksionale për administrimin kolektiv të kësaj të drejte, gjë që kërkon ngritjen ose përshtatjen e strukturave të posaçme dhe përcaktimin e qartë të kompetencave ndërmjet organizmave ekzistues, si Sporteli unik dhe agjencitë e administrimit kolektiv të licencuara në Republikën e Shqipërisë, sipas objektit të licencës. Megjithatë, nuk është kusht i domosdoshëm licencimi i një agjencie të veçantë për të drejtën e huadhënies publike, sepse shpërndarja e shpërblimeve për këtë të drejtë realizohet pa asnjë pengesë edhe nga agjencitë ekzistuese të licencuara. Mbledhja e të dhënave të sakta dhe të standardizuara nga bibliotekat, institucionet arsimore/akademike, përfshirë statistikën e huadhënies, kërkon një infrastrukturë të përditësuar teknologjike dhe bashkëpunim të vazhdueshëm ndër-institucional.

Miratimi dhe zbatimi i këtij projektvendimi pritet të gjenerojë një ndikim pozitiv në disa drejtime. Në aspektin ekonomik, do të sigurohet një burim i qëndrueshëm të ardhurash për mbajtësit e të drejtave përmes një mekanizmi transparent dhe të drejtë shpërndarjeje, duke rritur sigurinë e tyre financiare. Në aspektin kulturor dhe shoqëror, vendosja e huadhënies publike do të nxisë rritjen e prodhimit letrar dhe artistik kombëtar, do të përmirësojë aksesin e publikut në literaturë dhe art, si dhe do të fuqizojë rolin e bibliotekave publike në jetën komunitare. Në planin institucional dhe ndërkombëtar, implementimi i kësaj të drejte do të kontribuojë në harmonizimin e legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian në fushën e të drejtave të autorit dhe promovimit të kulturës, duke forcuar imazhin e Shqipërisë si një vend që respekton dhe nxit krijimtarinë intelektuale.

Shpërblimi nga huadhënia publike i referohet një skeme të veçantë nga shpërblimet që autorët marrin në tërësi nga përdorimi i veprave të tyre. Një nga parimet e ligjit kombëtar për të drejtën e autorit dhe legjislacionit ndërkombëtar në tërësi është që çdo përdorues që ka përfitime nga përdorimi i veprës së një autori, duhet të shpërblejë autorin. Megjithatë në rastin e huadhënies publike, jemi në kushtet kur përdoruesit nuk paguajnë për veprën e huazuar sepse e marrin nga bibliotekat të cilat e kryejnë këtë shërbim falas. Për këtë arsye, është parashikuar që shpërblimi i autorëve për këtë skemë të jepet nga buxheti i shtetit. Ky buxhet është i kufizuar dhe një nga qëllimet kryesore të tij është nxitja e veprimtarisë krijuese dhe kulturore. Bibliotekat kanë një numër të konsiderueshëm veprash dhe autorësh në koleksionet e tyre dhe nëse shpërblimi do të shpërndahej për të gjithë këto vepra dhe autorë, ata do të merrnin një shpërblim shumë të vogël dhe pothuajse të papërfillshëm. Për këtë arsye shumë vende vendosin kufizime për kategoritë e veprave përfituese. Në projektvendimin e propozuar janë vendosur kufizime në lidhje me numrin e faqeve dhe bashkautorëve për një libër, si dhe afatin e botimit të veprës bazuar në arsyetimin e mësipërm, si dhe:

- Shmangien e abuzimit, sepse disa autorë mund të botojnë vepra shumë të shkurtra me qëllim përfitimin e shpërblimit nga huadhënia publike;
- Mbështetjen e veprave letrare në kuptim të ligjit për të drejtën e autorit dhe gjuhës shqipe, për të mbështetur autorin që ka bërë një punë më serioze dhe përkushtuese;
- Diferencimin ndërmjet formave të ndryshme të publikimeve, që skema të mos mbingarkohet dhe fokusi të jëtë në veprat që kanë ndikim kulturor dhe artistik;
- Mbështetja e autorëve aktivë, të cilat kanë botuar vitet e fundit. Kjo tregon se autori është ende pjesë e jetës letrare dhe kulturore të një vendi. Ai nxitet për të vijuar krijimtarinë e tij. Gjithashtu, niveli i huazimit të veprave të vjetra vjen gradualisht duke rënë. Koleksioni i bibliotekave pasurohet gjithnjë e më tepër me tituj të rinj, duke e lidhur skemën e huadhënies publike me huazimet reale dhe aktuale;
- Ruajturi efikasitetin administrativ, sepse monitorimi dhe shpërblimi i autorëve të rinj është më i thjeshtë dhe efikas për tu realizuar;
- Efikasitetin financiar, që fondi të mos ndahet në pjesë shumë të vogla, por autorët përfitues të marrin një shpërblim të konsiderueshëm dhe të kënaqshëm, duke nxitur krijimtarinë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Ky projektvendim është hartuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 8, të nenit 32 të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të ndryshuar. Gjithashtu, hartimi i këtij projektakti është krijuar duke vlerësuar ngjashmëritë, dallimet dhe praktikat më të mira të sistemeve ndërkombëtare të së drejtës për huadhënien publike, si vijon:

1. Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe parimi i trajtimit kombëtar:

Parimi i trajtimit kombëtar (Neni 5(1) i Konventës së Bernës), sipas të cilit veprat që kanë origjinën në një nga shtetet anëtare duhet të mbrohen në secilin prej shteteve anëtare në të njëjtën mënyrë që këto shtete mbrojnë veprat e shtetasve të tyre.

2. Struktura ligjore e huadhënies publike:

Në legjislacionin Shqiptar për të drejtën e autorit përveç të drejtave jo pasurore, përcaktohen edhe të drejtat pasurore. Të drejtat pasurore janë të drejtat ekskluzive pasurore dhe të drejtat të tjera pasurore. E drejta e huadhënies publike përfshihet si një e drejtë tjetër pasurore ku autorët kanë të drejtën ekskluzive të autorizimit apo ndalimit të huadhënies publike të veprave, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga ky ligj, në të cilat autorët gëzojnë vetëm të drejtën për marrjen e shpërblimit të drejtë për përdorimin publik të veprës së tyre. Ky parashikim mund të hyjë në sistemet e huadhënies publike që njihen si një e drejtë kompensimi e veçantë e njohur me ligj.

3. Institucionet e përfshira në sistemin e të drejtës së huadhënies publike:

Në Republikën e Shqipërisë në skemën e huadhënies publike përfshihen: ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, si institucioni që jep shumën e shpërblimit për mbajtësit e të drejtave; Biblioteka Kombëtare, institucionet arsimore/akademike, bibliotekat publike me hyrje të lirë/pa pagesë të cilat japin veprat të mbrojtura nga e drejta e autorit në formën e huasë, si dhe informacionin mbi këtë procedurë; Sporteli unik që mbledh shpërblimet dhe agjencitë e administrimit kolektiv që bëjnë shpërndarjen e shpërblimeve tek mbajtësit e të drejtave.

4. Llojet e veprave të përfshira:

Veprat që mund të kualifikohen për huadhënie publike parashikohen dhe përcaktohen nga neni 32 i ligjit për të drejtën e autorit, duke përfshirë kategoritë e ndryshme të veprave të mbrojtura dhe kriteret specifike për përdorimin e tyre.

- Në bazë të pikës 2 të nenit 32 të ligjit, autorët kanë të drejtën ekskluzive të autorizimit apo ndalimit të huadhënies publike të veprave, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe nga ky ligj, në të cilat autorët gëzojnë vetëm të drejtën për marrjen e shpërblimit të drejtë për përdorimin publik të veprës së tyre;

- Në bazë të pikës 5 të nenit 32 të ligjit, autorët e veprave letrare dhe veprave muzikore në formën e fletës së pentagramit kanë të drejtën të marrin shpërblim të drejtë për dhënien e veprës së tyre publikut për huapërdorje;

Në zbatim të projektvendimit, termi “libër” ka të njëjtin kuptim si në ligjin për librin në Republikën e Shqipërisë dhe përfshin vetëm veprat që kanë një Numër Ndërkombëtar të Standardizuar të Librit (ISBN).

Në këtë përkufizim nuk përfshihen:

- librat që nuk janë ofruar për shitje për publikun;

- botimet periodike si gazeta, revista, buletine apo botime të përditshme dhe periodike;
- librat e botuar nga organizata jofitimprurëse;
- tekstet shkollore të destinuara për përdorim në shkolla;
- si dhe materialet grafike si grafikët, hartat, planet dhe tabelat.

Librat duhet të kenë të paktën 36 faqe, me përjashtim të librave për fëmijë, për të cilët nuk ka kufizime. Mëtej librat e kualifikuar nuk duhet të kenë më shumë se tre autorë, ndërsa redaktorët, autorët e parathënies dhe të teksteve hyrëse nuk do të përfshihen në rregullat e shpërblimit. Librat audio trajtohen njësoj si librat e tjerë dhe duhet të jenë të botuar në format fizik (CD) ose në formë shkarkimi digjital (MP3) brenda pesë viteve të fundit, me një kod ISBN 13-shifror të regjistruar. Për librat në format elektronik, ato duhet të jenë publikuar ose botuar brenda pesë viteve të fundit dhe gjithashtu të kenë një kod ISBN të regjistruar.

5. Përfituesit e shpërblimit:

Përfituesit e shpërblimit nga huadhënia publike përfshijnë autorët dhe krijuesit e veprave letrare, përkthyesit, fotografët, ilustruesit dhe krijuesit e veprave të artit pamor. Skema e shpërblimit do të bazohet mbi praktikën më të mira ndërkombëtare në mënyrë që të garantohet një shpërndarje e drejtë dhe e balancuar e kompensimit për përdorimin publik të veprave të tyre, në bazë të kontributit specifik dhe peshës së rolit në krijimin e veprës.

6. Financimi i huadhënies publike:

Financimi i skemave të shpërblimit për huadhënien publike është një çështje thelbësore për funksionimin efektiv dhe të drejtë të tyre. Ekzistojnë modele të ndryshme financimi në vende të ndryshme, në shumicën e rasteve, burimi kryesor i financimit është buxheti shtetëror. Në disa vende, si Holanda, financimi realizohet përmes bibliotekave individuale. Kur bibliotekat financojnë vetë shpërblimin për huadhënien publike, siç ndodh në Holandë, kjo shihet si një mënyrë e ligjshme dhe e drejtë për të kompensuar autorët për qasjen e lirë në veprat e tyre, duke marrë parasysh që bibliotekat në këto vende janë të zhvilluara në mënyrë të pavarur dhe përftojnë të ardhura nga aktivitete të pavarura nga buxhetet shtetërore. Modele të tjera inovative përfshijnë përdorimin e taksave specifike, si në Poloni, të cilat shoqërohen me përfitime të veçanta për tregun e librave. Megjithatë, për të shmangur vendosjen e një barrë të panevojshme ekonomike mbi bibliotekat, modeli më i përshtatshëm dhe i qëndrueshëm mbetet financimi shtetëror, qoftë përmes bashkive vendore apo buxhetit qendror, i cili duhet të sigurojë fonde të përcaktuara dhe shpërndarje të drejtë për librat që huazohen në të gjitha bibliotekat kombëtare. Modelin e financimit shtetëror e ndjekin shtete si Franca, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar.

7. Shpërndarja e huadhënies publike:

Shpërblimi për huadhënien publike paguhet në bazë vjetore dhe shpërndahet midis autorëve bazuar në veprat që janë huazuar. Shpërndarja bazohet në statistikat e huazimit, të mbledhura nga

raportimet e bibliotekave publike me hyrje të lirë/pa pagesë, Biblioteka Kombëtare, institucionet arsimore/akademike dhe të dhënat që ofrojnë ato.

Shpërblimi për huadhënien publike të veprave letrare ndahet kryesisht për shkrimtarët, përkthyesit, fotografët dhe ilustruesit dhe krijuesit e veprave të artit pamor.

Shpërndarja bëhet nga agjencitë në bazë të metodologjisë së shpërndarjes në zbatim të ligjit për të drejtën e autorit. Për hartimin e metodologjisë mbahen parasysh disa kritere të cilat lidhen me numrin e veprave, numrin e faqeve, llojin e veprës dhe për veprat me bashkautorë në bazë të kontributit. AAK-të mund të vendosin vlera fikse për shpërndarjet. Për shembull, veprat letrare të trilluara fitojnë më shumë pikë sesa veprat e tjera, ndërsa poezia vlerësohet gjashtëfish më tepër se trillimi.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin më të avancuar të legjislacionit me *acquis* e Bashkimit Evropian. Sqarojmë se ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar, është përafëruar me direktivën 2006/115/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12.12.2006 “Mbi të drejtën e qirasë dhe huadhënien publike”. Ky projektvendim synon përcaktimin e procedurës dhe shpërblimit të drejtë për huadhënien publike me qëllim zbatimin në praktikë të parimeve të vendosura në ligj. Megjithatë, projektakti nuk përmban dispozita që përafrojnë direktivën 2006/115/KE.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është i përbërë nga 6 nene:

Në **nenin 1**, është përcaktuar objekti dhe qëllimi i vendimit i cili lidhet me procedurën dhe mënyrën e shpërblimit të huadhënies publike dhe nxitjen e zhvillimit të krijimtarisë.

Në **nenin 2**, janë përcaktuar subjektet përfitues dhe fusha e zbatimit. Subjektet që do të përfitojnë nga të ardhurat e huadhënie publike janë autorët e veprave letrare dhe veprave muzikore në formën e fletës së pentagramit. Ndërsa veprat e kualifikuara për shpërblim janë ibrat e botuar, librat audio, librat në formë elektronike, partiturat muzikore që bëjnë pjesë në repertorin e Bibliotekës Kombëtare, institucioneve arsimore/akademike, si dhe bibliotekave publike me hyrje të lirë/pa pagesë. Në këtë nen përcaktohen dhe disa specifikime në lidhje me librat që përfshihen dhe përjashtohen nga skema e huadhënies publike, duke patur nxitjen e krijimtarisë dhe mbështetjen e autorëve, sikurse është shpjeguar në Kreun III të relacionit.

Në **nenin 3**, përcaktohet se shuma e shpërblimit të drejtë do të jepet nga ministria përgjegjëse për të drejtat e autorit çdo vit. Çdo tre vjet ministria e do të përcaktojë se sa do të jetë kjo shumë bazuar në kriteret që lidhen me promovimin kulturor, numrin e bibliotekave, financimi i tyre vjetor, numri total i vëllimeve në koleksionet e tyre, numri total i huadhënieve, praktikat kombëtare.

Në **nenin 4**, parashikohet mënyra dhe procedura e administrimit të së drejtës së huadhënies publike, e cila kryhet përmes administrimit kolektiv të detyrueshëm nga Agjencitë e Administrimit Kolektiv. Mbledhja e tarifave të shpërblimit, që jepet nga ministria, bëhet nga Sporteli unik, i cili më pas ua shpërndan agjencive të administrimit kolektiv. Kur ka më shumë se një agjenci të administrimit kolektiv për kategoritë përfituese të shpërblimit, duhet të arrihet një marrëveshje midis agjencive për shpërndarjen e saktë të shpërblimit. Nëse nuk arrihet marrëveshja midis agjencive vendimmarrja vendimi për shpërndarjen merret nga Këshilli Kombtar për të Drejtën e Autorit, sipas procedurës së specifikuar në projektakt. Nëse agjencitë nuk bien dakord me këtë vendim, kanë të drejtë t'i drejtohen gjykatës kompetente.

Në **nenin 5**, parashikohet se shpërndarja e shpërblimeve vjetore për huadhëien publike bazohet në statistikën e Bibliotekës Kombëtare, institucioneve arsimore/akademike, si dhe bibliotekave publike me hyrje të lirë/pa pagesë. Shpërndarja të autorët nga agjencia e administrimit kolektiv do të realizohet në bazë të metodologjisë së shpërndarjes së agjencisë e cila e krijon bazuar në kriteret si: numrin e veprave, numrin e faqeve, llojin e veprës dhe për veprat me bashkautorë në bazë të kontributit. AAK-të mund të vendosin vlera fikse për shpërndarjet.

Në **nenin 6**, përcaktohen dispozitat e fundit dhe kalimtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohet për zbatimin e këtij projektvendimi Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit. Ngarkohen Biblioteka Kombëtare, institucionet arsimore/akademike dhe bibliotekat publike me hyrje të lirë/pa pagesë për detyrimin për dhënie të informacionit në zbatim të këtij vendimi. Ngarkohet Sporteli unik dhe agjencitë e administrimit kolektiv për shpërndarjen e shpërblimit në zbatim të këtij vendimi. Ngarkohet Drejtoria për të Drejtën e Autorit për monitorimin e veprimtarisë së Sportelit unik dhe agjencive të administrimit kolektiv për huadhënie publike.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar dhe propozuar nga Drejtoria e të Drejtës së Autorit, pjesë e Ministrisë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, në bashkëpunim me ekspertin ndërkombëtar të fushës së huadhënies publike.

Projektvendimi është dërguar për mendim të: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Sportelit Unik për kryerjen e funksionit të mbledhjes së shpërblimeve, Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të drejtave të autorëve “Albautor”, Agjencisë së Administrimit Kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues “AKDIE”, Agjencisë së Administrimit Kolektiv “Faber Collective Phonogram”, Agjencisë së Administrimit

Kolektiv të Filmit Audiovizual, Artistik dhe Dokumentar “F.A.A.D”, Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim shoqërohet me efekte financiare në buxhetin e shtetit. Pas hyrjes së Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe fillimit të zbatimit të projektvendimit, ministria përgjegjëse për të drejtën e autorit, do të ndërmarrë hapat e nevojshëm për ndjekjen e procedurave sipas ligjit nr. 9936/2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar.

X. HYRJA NË FUQI E PROJEKTVENDIMIT

Ky vendim hyn në fuqi në datën e hyrjes së Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

MINISTRI

Blendi GONXHJA